



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**STRATEGJIA PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
DHE RADIKALIZMIT QË SHPIE NË TERRORIZËM 2015 – 2020**

Prishtinë, shtator 2015

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
1. PËRMbledhje EKZEKUTIVE	5
2. METODOLOGJIA E PËRDORUR NË HARTIMIN E STRATEGJISË.....	7
3. LISTA E PËRKUFIZIMEVE DHE SHKURTESAVE	8
4. ANALIZA E SITUATËS DHE SHTRIRJA E PROBLEMIT	9
4.1 Analizë e situatës dhe shtrirja e problemit	9
4.1.1 Kërcënimet nga brenda Kosovës.....	10
4.1.2 Kërcënimi rajonal dhe nevoja për bashkëpunim.....	11
4.2 Ekstremistët e dhunshëm dhe motivet e ekstremizmit	12
4.2 Faktorët “Shtytës dhe Tërheqës” të radikalizmit dhe rreziqet për Kosovën	13
4.2.1 Faktorët shtytës	13
4.2.1.1 Faktorët ekonomik dhe social	13
4.3.1.2 Kapaciteti dhe integriteti i ulët institucional	14
4.3.2 Faktorët tërheqës	14
4.3.2.1 Prijësit radikalë	14
4.3.2.2 Radikalizimi online.....	14
4.4 Përmbledhje e analizave dhe vlerësimi i rrezikut nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.....	15
4.5 SWOT Analiza.....	16
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	18
5.1 Identifikimi i hershëm i shkaqeve, faktorëve, grupeve të targetuara dhe mënyrave të radikalizmit	18
5.2 Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm	20
5.3 Intervenimi – me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm	24
5.4 De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar	25
6. ALTERNATIVAT E SHQYRTUARA DHE QASJA E REKOMANDUAR PËR PARANDALIMIN E EKSTREMISMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT	27
7. HARTIMI, RISHIKIMI, MIRATIMI, ZBATIMI DHE MEKANIZMAT MONITORUES TË STRATEGJISË.....	29
7.1 E përgjithshme	29
7.2 Plani i veprimit për implementimin e strategjisë	29
7.3 Implementimi, monitorimi dhe mekanizmat monitorues për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit.....	29
7.4 Kontribuuesit dhe rolet e tyre.....	30
7.5 Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit.....	32
7.6 Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit	33

HYRJE

Kërcënimi nga radikalizmidheekstremizmi dhunshëm nuk është një fenomen i ri në botë. Përdorimi i dhunës politike dhe shkatërrimit për të frikësuar dhe dobësuar shtetet dhe popujt ka qenë i pranishëm përgjatë shekujve, kudo dhe kurdo që një grup politik ose fetar kërkon të destabilizojë dhe dobësojë kufijtë, qeveritë dhe shoqëritë duke dëmtuar civilët dhe shoqëritë përmes akteve të terrorit. Megjithatë, forma moderne e radikalizmidheekstremizmit të dhunshëm është një fenomen i ri. Ky fenomen i ri mbështetet në anët e forta dhe të dobëta të botës së globalizuar për të përhapur mesazhet e grupeve terroriste, për të siguruar fonde për grupet përkrahëse dhe veprimtaritë kriminale, dhe për më tepër duke bërë rekrutimin e anëtarëve të rinj për arritjen e qëllimeve të tyre edhe në vendet cilat ndodhen larg konflikteve.

Ngjarjet që kanë ndoshur në vitet e fundit në Kosovë, Evropë, Lindjen e Mesme dhe më gjerë e kanë bërë të qartë nevojën dhe interesin e Republikës së Kosovës që të hartoj një strategji përmes të cilës do të koordinohen masat në forcimin e qëndrueshmërisë së shtetit dhe shoqërisë ndaj kërcënimeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Në këtë mënyrë, ne si Republikë e Kosovës do të qëndrojmë së bashku me miqtë dhe aleatët tanë në mbarë botën të cilët janë duke u përballur me këtë kërcënim të përbashkët.

Kërcënimi më i madh aktualisht duket të jetë i ashtuquajturit ISIS me bazë në Siri dhe Irak, por që nuk përbënës kërcënimin parë dhe as të fundit për nga natyra e tillë me të cilin bota bashkëkohore ka të ngjarë të përballlet. Konfliktet e ndryshme në rajon dhe në vendet me të cilat një pjesë e popullsisë së Kosovës kanë lidhje tradicionale, kulturore dhe historike përbën burim tjetër e cila mund t'i tërheqë qytetarët e Republikës së Kosovës drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Për Kosovën, ky kërcënim nuk është vetëm global por përbënë edhe kërcënim lokal, i cili duhet të merret parasysh shumë seriozisht. Disa kosovarë janë joshur nga mesazhet radikalizuese, duke iu bashkangjitur dhe luftuar përkrah grupeveekstremiste dhe terroriste, dhe në shumë raste janë kthyer në Kosovë pasi kanë qenë prezent apo kanë kryer vepratë kundërligjshme në emër të idealit të tyre. Por, është e rëndësishme të dimë përse shkuan? Çfarë u ishte thënë, nga kush dhe pse u bënë të dëgjueshëm? Dhe më e rëndësishmja, çfarë mund të bëhet për të siguruar që personat e prekur nga këto grupetë parandalohen nga përfshirja në veprime të dhunshme? Shumë nga këto pyetje janë adresuar përmes analizave që ka kryer Qeveria e Republikës së Kosovës në funksion të përgatitjes së këtij dokumenti strategjik, si një politikë e koordinuar edhe me partnerët dhe miqtë tanë ndërkombëtar, si dhe me një bashkëpunim të ngushtë edhe me komunitetet fetare, përfaqësuesit nga shoqëria civile, OJQ të ndryshme si dhe përfaqësues tëmedieve,duke synuar identifikimin e shkaqeve dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Adresimi i këtyre sfidave me qëllim të parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përbënë një çështje urgjente për Republikën e Kosovës. Fenomeni i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që qon në terrorizëm nuk tregon shenja të zhdukjes, por për më tepër ata të cilët shfaqin bindje radikale është parë se janë të gatshëm që të sulmojnë personat e pafajshëm si brenda ashtu edhe jashtë vendit të tyre. Asnjë forcë nuk mund të mbrojë një shtet nga një kërcënim i tillë, ku persona të vetëm apo grupe të vogla nga brenda vendit kërkojnë të

shkaktojnë, pa pasur konsideratë për jetën e tyre ose jetën e të tjerëve. Edhe institucionet e Republikës së Kosovës veçmas institucionet e sigurisë, të cilët kanë bërë një punë të madhe për të zbuluar dhe parandaluar komplete terroriste, mund të shërbejnë vetëm për të trajtuar simptomat e radikalizmit dhe jo shkakun. Prandaj, për të eliminuar me të vërtetë kërcënimin nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi ne duhet të përcaktojmë faktorët që janë shkaktarë të ekzistencës së tij në Kosovë, duke përdorur dialogun, analizat, dhe ekspertizën si nga partnerët kombëtarë dhe ata ndërkombëtarë.

Qeveria e Republikës së Kosovës e konsideron këtë si një hap të rëndësishëm për të ndërtuar një shtet dhe shoqëri të fortë dhe të qëndrueshme për të luftuar këtë dukuri globale dhe për të siguruar që kjo dukuri nuk ka vend në Kosovë. Për të arritur këto synime ne do të qëndrojmë dhe punojmë së bashku ndaj këtij kërcënimi me partnerët tanë në rajon dhe më gjerë.

Isa Mustafa, Kryeministri i Republikës së Kosovës

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm që shpie në terrorizëm është shfaqur si një kërcënim global, rajonal dhe kombëtar në një formë të re në shekullin e 21. Natyra e këtij rreziku vazhdon të zhvillohet në botë globalizuar. Ekstremizmi dhe terrorizmi kanë gjetur mënyra për të shfrytëzuar ndryshimet e shpejta të viteve të fundit, ku personat dhe kapitali mund të lëvizin përtej kufijve më lehtë dhe idetë mund të komunikohen menjëherë nëpërmjet internetit. Në këtë mënyrë, globalizimi ka ndikuar që krizat që në të kaluarën kanë qenë kriza lokale sikurse luftërat e brendshme, varfëria, papunësia, paqëndrueshmëria sociale dhe niveli i ulët i arsimit të shndërrohen në kërcënime përsigurinë ndërkombëtare. Prandaj, dobësitë në këto fusha përbëjnë mundësi për ekstremistët që të përhapin pikëpamjet e tyre, të rekrutojnë anëtarët dhe përkrahësit, dhe të përhapin luftën e tyre kundër shteteve laike në fushëbeteja të reja.

Në vitet e fundit edhe Kosova përballlet me këtë kërcënim në të njëjtën formë sikurse shumica e shteteve evropiane, konkretisht radikalizmin e të rinjve, të rekrutuar për të marrë pjesë në konfliktet sektare dhe fetare të Lindjes së Mesme dhe gjetiu. Rreziku kryesor me të cilin përballlet Kosova është kthimi i luftëtarëve të tillë me bindje radikale dhe me një interes për ta dëmtuar Kosovën si një shtet me shoqëri shumë-etnike dhe shumë-fetare dhe me një qeveri laike. Siç është parë nga shembuj të shumtë në Evropë, individët e radikalizuar mund të kryejnë akte të dhunës ekstreme edhe ndaj popullsisë dhe institucioneve edhe në shtetin e tyre, prandaj edhe rreziku që Kosova do të mund të jetë në shënjestër për një sulm të tillë terrorist nuk mund të përjashtohet. Edhe grupet radikale nacionaliste ekstremiste me origjinë serbe dhe shqiptare, që kundërshtojnë kufijtë dhe qeverisjen ekzistuese, mund të jenë gjithashtu një burim potencial i veprimtarisë terroriste.

Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë e popullsisë së saj së bashku me mbrojtjen e të drejtave të tyre për lirinë e mendimit dhe besimit. Në funksion të kësaj, Qeveria është e vendosur për të zhvilluar një strategji e cila do ta adresojë rrezikun e sigurisë që vjen nga radikalizimi dhe ekstremizmi në një mënyrë të përgjegjshme, duke respektuar garantimin e të drejtave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, se "askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose të origjinës kombëtare apo sociale të të tjerëve, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal". Si një anëtar i familjes së vendeve demokratike, Republika e Kosovës është gjithashtu e vetëdijshme për rolin dhe përgjegjësitë e veta për sigurinë rajonale dhe globale. Përbushja me sukses e këtyre përgjegjësisë kërkon një platformë të plotë strategjike që merr parasysh sfidat transnacionale të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që qon në terrorizëm dhe rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit rajonal në adresimin e këtij kërcënimi.

Objektivat strategjike të përcaktuara me këtë dokument strategjik synojnë që të adresojnë faktorët shtytës dhe tërheqës që ndikojnë në radikalizimin e popullsisë, në veçanti të rinjve. Përmes arritjes së katër objektivave strategjike: Identifikimi i hershëm - i shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara; Parandalimi - i ekstremizmit dhe radikalizimit të dhunshëm; Intervenimi – me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm; De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar si dhe objektivat specifike/masat në kuadër të tyre Qeveria e Republikës së Kosovës ka për qëllim që të parandalojë dhe zvogëlojë rrezikun nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Plani i veprimit i cili është pjesë e kësaj strategjie

përmes objektivave specifike dhe aktiviteteve konkrete përmes tyre synohet që ndër të tjera të rritet vetëdija si në mesin e institucioneve po ashtu edhe të qytetarëve sa i përket rreziqeve që vijnë nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm. Krahas ngritjes së vetëdijes edhe veprimet konkrete në adresimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës zënë vend në kuadër të objektivave strategjike dhe specifike të kësaj strategjie.

Implementimi i këtyre objektivave strategjike dhe masave konkrete do të bëhet në linjë me iniciativat Evropiane dhe globale për luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që përmes kësaj strategjie të kontribuojë në implementimin e konkluzioneve të Samitit të Washingtonit në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.¹ Nga ky samit u konstatua nevoja për të bashkuar dhe koordinuar përpjekjet në parandalimin e ekstremizmit dhe ruajtjen e tolerancës fetare në mbarë globin, e në veçanti në vendet e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm. Po ashtu, gjatë këtij viti Këshilli i Evropës ka miratuar një plan veprimi 2015-2017 për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm i cili përmban dy objektiva dhe një sërë aktivitesh në këtë funksion.² Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm do të kontribuojë edhe proceseve integruese të Republikës së Kosovës në mekanizmat Euroatlantike, prandaj, implementimi i kësaj strategjie do të jetë njëri nga prioritetet kyçe për Republikën e Kosovës në periudhën afatmesme.

¹ Samiti i Shtëpisë së Bardhë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm u mbajt më 19 shkurt në Washington D.C, ShBA. në këtë samit morën pjesë mbi tetëdhjetë përfaqësues të qeverive dhe ministra, si dhe përfaqësues nga shoqëria civile, sektori privat, udhëheqës fetar si dhe akademikë.

² Council of Europe, Action Plan - The fight against violent extremism and radicalisation leading to terrorism, 125th Session of the Committee of Ministers (Brussels, 19 May 2015) CM(2015)74 add final.

2. METODOLOGJIA E PËRDORUR NË HARTIMIN E STRATEGJISË

Strategjia fokusohet së pari në një analizë përshkruese përmes të cilës synohet të që definohet shtrirja e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit në Kosovë, për të siguruar një vlerësim të rrezikut që paraqet radikalizmi dhe terrorizmi brenda shtetit, si dhe një analizë të faktorëve socialë që kanë motivuar disa shtetas të Kosovës që të radikalizohen. Kjo mundëson të kuptohet shtrirja e problemit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm me qëllim të adresimit dhe parandalimit të tij. Së dyti, një plan veprimi i bazuar në katër shtylla - objektiva strategjike (identifikimi i hershëm, parandalimi, ndërhyrja, de-radikalizmi dhe riintegrimi) si dhe objektivat (masat) specifike në kuadër të këtyre katër objektivave strategjike do ndihmojnë më tej në adresimin dhe parandalimin e fenomenit të radikalizmit në Kosovë dhe të caktojë kundërmasat dhe veprimet parandaluese për ministritë përkatëse të qeverisë dhe agjencive sipas kapaciteteve dhe ekspertizës së tyre. Për tu arritur objektivat e tilla do të jetë i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë dhe pjesëmarrje nga shoqëria civile, bashkësitë fetare, ekspertët dhe aktorë të tjerë jo-shtetërorë për të siguruar se politikat janë të përshtatura me nevojat e individëve dhe komuniteteve që synohet tu ndihmohet. Objektivat strategjike dhe ato specifike të parapara me këtë strategji koordinohen edhe me politikat dhe strategjitë tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke përfshirë Strategjinë kundër terrorizmit, duke synuar që të mos dyfishohen analizat dhe konkluzionet e kryera në kuadër të saj por të plotësojë ato, por edhe strategjive dhe politikave tjera që adresojnë faktorët ekonomik, social, kulturor dhe arsimor.

Në hartimin e kësaj strategjie kanë qenë të përfshirë akterë të ndryshëm si brenda dhe jashtë Qeverisë. Në kuadër të Qeverisë, u themelua një grup punues qeveritar me përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, AKI, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, si dhe agjencitë e ndryshme të qeverisë dhe po ashtu me përfaqësues nga bashkësitë fetare dhe OJQ-të. Akterëndërkombëtarë dhe OJQ-të kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces, duke përfshirë mbështetjen e OSBE-së dhe UNDP për të siguruar organizimin e punëtorive dhe duke hartuar një raport kërkimor nga konsulentët e jashtëm, si dhe përkrahjes së drejtpërdrejtë me ekspertë në hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Procesi i hartimit të Draftit të Strategjisë u koordinua nga Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit.

Pjesëmarrja e bashkësive fetare të Kosovës, OJQ-ve dhe partnerëve tjerë përbënë një kontribut të vlefshëm në punën e grupit punues. Mbështetja dhe kontributi i dhënë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Zyra e BE-së po ashtu ka kontribuar tej mase në procesin e hartimit të kësaj strategjie.

3. LISTA E PËRKUFIZIMEVE DHE SHKURTESAVE

Përkufizimet e dhëna më poshtë, përshkruajnë se si janë përdor këto fjalë në këtë dokument, për hir të qartësisë. Nuk ka asnjë qëllim të kritikohen autorët tjerë, që përdorin këta terma në mënyra të ndryshme.

- **Ekstrem, Ekstremizmi:** mund të përkufizohet vetëm në lidhje me ideologjinë më të gjerë, që vepron p.sh. në kuadër të nacionalizmit ekstrem, ambientalizmit ekstrem, ekstremizmit fetar. Tipari përkufizues i ekstremizmit është refuzimi i një ose më shumë parimesh bazë të ideologjisë së saj kryesore. Një nacionalist i cili i konsideron pjesëtarët e të gjitha kombeve të tjera si inferiorë, ose që refuzon mundësinë e bashkëjetesës, apo beson se të tjerëve duhet t'u mohohen të drejtat, është një nacionalist ekstrem. Një besimtar fetar i cili dënon udhëheqësit ose pjesën më të madhe të anëtarëve të besimit të tij është një ekstremist. Ekstremistët nuk janë medoemos të dhunshëm.
- **Xhihad, xhihadist:** Përderisa fjala "xhihad" përdoret shpesh në Islamin qendror, që do të thotë një luftë shpirtërore, në këtë raport është përdorur vetëm për të përkufizuar luftën e armatosur, të dhunshme. Xhihadisti është një mysliman, i cili ka vendosur të përdorë forcën në shërbim të besimeve të tij ose të saj.
- **Radikalizmi:** procesi i miratimit të ideologjiveekstremiste dhe në disa raste shndërrimi në një ekstremist të dhunshëm.
- **Selefi, Selefizëm:** përshkruan një person, grup apo besimin brenda Islamit që përqendrohet në imitim të gjeneratave të hershme të myslimanëve ("Selefët") dhe restaurimin e fesë të pastër. Shumica e selefive nuk janë të dhunshëm, dhe shumica i shmangen angazhimit politik të çdo lloji, ndërsa, disa janë politikisht aktiv. Një pakicë e selefive janë ekstremistë të dhunshëm apo xhihadistë.
- **Terrorizmi:** përdorimi i dhunës me qëllim të shkaktimit të terrorit mbi popullsinë civile. Terrorizmi është një lloj i veçantë i ekstremizmit të dhunshëm.
- **Ekstremizmi i dhunshëm:** Ekstremizmi që përvetëson përdorimin e dhunës; përfshin, por nuk kufizohet vetëm në terrorizëm. Për shembull, ekstremistët e dhunshëm që sulmojnë pjesëtarët e policisë ose të ushtrisë, ose që marrin pjesë në luftime, zakonisht nuk janë terroristë.
- **ISIS** – Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë -

4. ANALIZA E SITUATËS DHE SHTRIRJA E PROBLEMIT

4.1 Analizë e situatës dhe shtrirja e problemit

Republika e Kosovës sikurse edhe vendet e tjera demokratike ballafaqohet me kërcënime të vazhdueshme nga radikalizmi dhe ekstremizmi që mund të qojnë në përdorim të dhunës. Në këtë kuadër institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara në përmbushjen e detyrave që dalin nga baza ligjore dhe strategjitë kombëtare në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të radikalizmit dhe ekstremizmit me bazë fetare, politike dhe nacionale, ngritjen e kapaciteteve vendore për t'iu kundërvënë këtij kërcënimi si dhe për të qenë partner i rëndësishëm ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit. Qytetarët e Republikës së Kosovës janë të përkushtuar për integritet evropian dhe të ardhmen e vet e shohin në kuadër të integritetit brenda BE-së dhe se radikalizmi dhe ekstremizmi i çfarëdo lloji nuk gëzon mbështetjen e shumicës dërmuese të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Duhet vlerësuar se populli i Kosovës ka ruajtur një tolerancë fetare përgjatë shekujve. Një tolerancë e tillë në veçanti ekziston në mes kombit shqiptar i cili i përket të tre besimeve më të mëdha: myslimane, katolike dhe ortodokse. Duhet theksuar realitetin se identifikimi i qytetarëve të kombit shqiptar me besimin fetare nuk përkon në domenin e identitetit por është shtresim kulturor. Edhe hulumtimet e fundit nga organizata ndërkombëtare të kryera gjatë vitit 2011 dhe 2012, mbështesin konstatimin se në Kosovë ka një tolerancë të lartë fetare.³ Këto hulumtime po ashtu konfirmojnë imazhin popullor të kosovarëve si përkrahës të vlerave pro-perëndimore.

Prandaj, proceset nëpër të cilat po kalon shoqëria kosovare kërkojnë një koordinim dhe bashkëpunim të gjerë ndërmjet institucioneve vendore dhe të gjithë akterëve të jetës publike dhe fetare me synim që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë një informim të drejtë dhe të mos bien viktimit e nxitjes së urrejtjes fetare, nacionale a racore dhe të krijojnë idenë e funksionimit të shoqërisë demokratike ku secili e shfaq bindjen e vet në mënyrë të lirë dhe pa u penguar si dhe pa fyer tjetrin.

Sidoqoftë, aktiviteti i personave me prirje radikale fetare, politike dhe nacionaliste është i pranishëm edhe në Republikën e Kosovës, kryesisht në aspektin e thirrjes, ku përfshihet mbajtja e ligjëratave fetare/nacionaliste, propaganda në internet, organizimet përmes grupeve dhe OJQ-ve të ndryshme, madje po gjen hapësirë edhe në fushat tjera si në sport në mesin e grupeve të tifozëve dhe grupeve huligane, etj. Një ndikim jo të vogël në këtë mes kanë individë nga vendet fqinje të cilët ushtrojnë ndikimin e tyre tek qytetarët e Republikës së Kosovës të papenguar nga institucione e vendeve përkatëse.

Bazuar në këto rryma dhe pikëpamje radikale me bazë fetare dhe nacionaliste janë identifikuar rastet e përdorimit të dhunës ndaj pjesëtarëve të institucioneve të sigurisë, vendore dhe

³ Qendra e Hulumtimit Pew, *Muslimanët e Botës: Feja, Politika dhe Shoqëria*, 2013, fq.150, 153.

ndërkombëtare⁴, ndaj qytetarëve të përkatësive të ndryshme nacionale dhe të bindjeve të ndryshme fetare si dhe pjesëmarrje e shtetasve të Republikës së Kosovës në luftimet jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Prandaj, kur jemi tek kërcënimet nga radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm duhet të cekim se si rezultat i përqafimit të këtyre bindjeve/ ideve me dhjetëra persona shtetas të Kosovës i janë bashkangjitur organizatave terroriste jashtë territorit të Kosovës ku disa prej tyre kanë mbetur të vrarë në këto konflikte.

Përhapja e dukurisë së ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm në Republikën e Kosovës, ka ndodhur përmes disa OJQ-ve, shoqatave dhe individëve vendor dhe të huaj që kanë përqafuar rrymat radikale. Një rol të veçantë në përhapjen e mësimëve radikale ekstremiste, vazhdojnë ta luajnë persona me ndikim publik të cilët e kanë arritur edhe epitelin e liderëve shpirtëror. Ndonëse nuk është i vetmi, radikalizmi që identifikohet me aspektet fetare paraqet një rën nga rreziqet kryesore që mund të shpie në ekstremizëm dhe terrorizëm që mund të prish tolerancën fetare që ekziston në Kosovë. Sa i përket shkallës së shtrirjes së fenomenit, numri i pjesëmarrësve nga Kosova në ekstremizmin e dhunshëm është në kuadër të normave të përgjithshme të vendeve të tjera evropiane, edhe pse është e rëndësishme që të merret parasysh se grupet e ndryshme individuale dhe kombëtare mund të marrin pjesë dhe të lënë vendet e tyre për arsye të ndryshme.⁵

Shoqëria kosovare, në të gjitha nivelet e saj, është duke e kundërshtuar një përhapje të tillë të radikalizmit dhe ekstremizmit të të gjitha llojeve me bazë fetare dhe nacionale, me përjashtim të një pjese të vogël të popullatës, gjendja socio-ekonomike e së cilët është mjaft e rëndë dhe të cilët në mungesë të një informimi të drejtë edhe bien viktimë e këtyre rrymave radikale ekstremiste.

Toleranca ndërfaqetare që ekziston në Kosovë dhe mospërkarhja nga ana e Qytetarëve të Republikës së Kosovës e formave të ekstremizmit dhe radikalizmit ekstrem janë faktor të rëndësishëm që duhet të merren parasysh me rastin e adresimit të sfidave nga ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm që shpie në terrorizëm. Po ashtu, lidhjet e forta që ende ekzistojnë në familje dhe komunitet mundësojnë që format e ekstremizmit dhe radikalizmit të identifikohen dhe parandalohen me kohë. Prandaj, edhe kjo strategji do të ketë si pikënisje pikërisht këto vlera dhe tolerancë që ekziston në shoqërinë Kosovare për të adresuar sfidat nga ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm.

4.1.1 Kërcënimet nga brenda Kosovës

Kur jemi tek ekstremizmi i dhunshëm, nuk mund të lëmë pa përmendur Veriun e Kosovës i cili ka qenë një vatër e ekstremizmit të dhunshëm të paktën që prej vitit 1999, për të vazhduar më tej edhe pasi Kosova shpalli pavarësinë në vitin 2008. Situata e krijuar në veri të vendit përbën bazë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit radikal ekstremist të grupeve, individëve dhe organizatave radikale serbe vendore dhe me origjinë nga Serbia.

⁴Sipas Databazës Globale të Terrorizmit, në vitin 2013 janë rexhistruar gjashtë incidente të të terrorizmit në Kosovë (me një person të vrarë), pesë në vitin 2012 (tre të vrarë), dhe nga një në vitin 2009, 2010 dhe 2011, <http://www.start.umd.edu/gtd/search/Results.aspx?country=1003>. Sidoqoftë këto incidente që kanë ndodhur në Kosovë nuk kanë pasur një prapavijë të ekstremizmit fetar.

⁵ Intervistë me zyrtar të Departamentit të Anti-terrorizmit të Policisë së Kosovës dhe të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Prishtinë, Maj 2015.

Grupet Radikale që kanë vepruar dhe veprojnë në këtë pjesë kanë qenë të ndërlidhura edhe me partitë politike serbe me orientim radikal⁶ Me arritjen e disa marrëveshjeve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, nën negocimin e Bashkimit Evropian situata pritet të ketë zhvillime pozitive, megjithëse qytetarët në atë pjesë ndihen të braktisur dhe të rinjët kanë mbetur pa një orientim të qartë për fatin e tyre.

Një kërcënim tjetër jo më pak i rëndësishëm është radikalizmi i dhunshëm që identifikohet me aspektet fetare. Kjo ka të bëjë kryesisht me qytetarët e Republikës së Kosovës që u janë bashkuar konflikteve në Siri dhe Irak e një pjesë e të cilëve janë kthyer në Kosovë. Ndonëse nga vlerësimet e bëra deri më tani del se një numër prej rreth 300⁷ kosovarësh në faza të ndryshme i janë bashkuar konfliktit në Siri dhe Irak, deri më tani në Kosovë nuk ka ndodhur ndonjë sulm terrorist i cili ka prapavijë ekstremiste fetare.

Kosova dhe vendet e rajonit nga grupet ekstremiste/terroriste si ISIS dhe të ngjashme shihen si vende për rekrutimin e luftëtarëve.⁸ Mirëpo, është me rëndësi të përmendet po ashtu fakti i kërcënimeve specifike dhe udhëzimeve nga ISIS për anëtarët e vet, simpatizuesit dhe përkrahësit, që të kryejnë sulme terroriste në vendet e tyre të origjinës.⁹ Duke pas paraysh edhe faktorët tjerë të rrezikut përfshirë ata shtytës dhe tërheqës duke përfshirë ndikimin e ideologjive ekstremiste, këto kërcënime duhet të trajtohen me seriozitet nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës.

4.1.2 Kërcënimi rajonal dhe nevoja për bashkëpunim

Edhe pse kjo strategji fokusohet në Kosovë, është e rëndësishme të theksohet edhe natyra rajonale e kërcënimit nga radikalizmi, e cila mbart me vete një rrezik më të madh të vënies në funksion të këtij radikalizmi për të gjithë Ballkanin Perëndimor. Ekziston mundësia që të njëjtat përpjekje për rekrutime në grupe të radikalizuara dhe për të koordinuar sulme si në Kosovë apo në vende të tjera të Ballkanit, përfshirë Kosovën, Maqedoninë dhe Shqipërinë, si dhe rajonin e Sanxhakut të Serbisë dhe popullsisë së saj kryesisht myslimane por edhe vendet tjera në rajon të paraqiten në të ardhmen. Lëvizja në mes të kufijve të vendeve të Ballkanit është e lehtë, prandaj, edhe rekrutimi në grupet radikale është i lehtë.¹⁰

⁶ Sponsorët formalë ishin Partia Radikale Serbe, një parti e ekstremit të djathtë, por ligjore, Srpski Obraz, pasardhëse e lëvizjes ultranacionaliste Obraz, një lëvizje e ndaluar në Serbi nga viti 2012, dhe Nasi, një grup i qytetarëve konservatorë; Flamujt e të ashtuquajturës " Ravnogorski pokret " (lëvizje çetnike) e Kosovës gjithashtu valviteshin në turmë. Tubimi ishte paqësor dhe u vëzhgua nga Policia e Kosovës.

⁷ Sipas të dhënave nga institucionet e sigurisë, ky numër prej 300 personash përfshinë edhe anëtarët e familjes dhe personat që nuk kanë marrë pjesë drejtpërdrejtë në luftime. Prandaj, numri i personave që aktualisht marrin pjesë në konfliktet e huaja është shumë më i vogël se 300.

⁸ Florian Bieber, profesor në Universitetin e Grazit në Austri, Artikull në Koha Ditore, 29. 07. 2015, <http://koha.net/?id=27&l=68492>

⁹ Në një deklaratë/udhëzim të publikuar nga ISIS në shtator të vitit 2014 udhëzohen përkrahësit e tyre që të kryejnë sulme terroriste në vendet prej nga vijnë.

¹⁰ Raportet tregojnë se xhihadistët dhe rekrutuesit kanë lëvizur pa vështirësi në mes të Kosovës dhe Bosnjës, në disa raste përmes Novi Pazarit, Serbi ku haptazi rekrutuesit pro-IS kanë operuar.

Prandaj, bashkëpunimi i të gjitha shteteve të rajonit për të identifikuar dhe parandaluar radikalizmin është mëse i nevojshëm. Mospranimi i realitetit të ri në rajon dhe mosnjohja e Republikës së Kosovës nga ana e Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës dhe si rrjedhojë edhe mungesa e bashkëpunimit në mes të institucioneve të sigurisë, në veçanti në shkëmbimin e informacionit e bënë një rrezik nga radikalizmi i dhunshëm edhe më prezent në nivel rajonal. Edhe pse një bashkëpunim nëpërmjet përfaqësuesve të EULEX dhe policisë së këtyre vendeve ekziston, kjo nuk është e mjaftueshme për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm në shkallën e duhur.

4.2 Ekstremistët e dhunshëm dhe motivet e ekstremizmit

Në rastin e Kosovës pjesëmarrja e dhjetëra qytetarëve në luftërat e huaja, e po ashtu grupet ekstremiste të motivuara etnikisht dhe politikisht që veprojnë kryesisht në veri të Kosovës mund të konsiderohen si ekstremistë të dhunshëm. Përveç kësaj, ka mundësi që shumë të tjerë të jenë radikalizuar dhe do të dëshironin të udhëtojnë për të luftuar në konflikte të tilla që kanë të bëjnë me ekstremizmin etnik, nacionalist apo fetar. Por, kush janë ata? Pse ata janë të motivuar për të ndryshuar jetën e tyre në pajtim me pikëpamjet apo ideologjitë ekstreme fetare? Pse bien pre dhe bëhen të dëgjueshëm ndaj rekrutuesve radikal?

Procesi i radikalizmit zakonisht fillon me rritjen e vetëdijesimit të një personi për një identitet politik ose social, i cili shpesh shkaktohet nga ndonjë ngjarje ose nga ndonjë grup i jashtëm. Kjo mund të shkaktojë që ata të shohin botën si të ndarë në grupe konkurruese (grupit të vet dhe grupeve tjera që mund të jenë armiqësore ndaj tij). Ky proces është shumë i zakonshëm në mbarë botën por që sigurisht nuk nënkupton që automatikisht të rezultojë në radikalizëm të dhunshëm. Dikush që identifikon vetën shumë me grupin e vet mund të bëhet pjesë e një komuniteti protestues politik, organizate apo lëvizje e cila është ende jo e dhunshme dhe përdor forma legjitime të protestës për të sjellë ndryshime në politikën e qeverisë për të adresuar ankesat.

Kërkohet diçka më shumë që ajo të shndërrohet në dhunë. Mundë të jenë gjëra të ndryshme që mund të shtyjnë që ajo të shndërrohet në dhunë, duke filluar nga një ndjenja se protesta politike është e paefektshme, rritja e "zemërimit moral" në një veprim të kryer nga një grup tjetër, ose shkak mund të jetë diçka që ndërlikohet me psikologjinë ekstremiste.

Të rinjtë, veçanërisht djemtë e rinjtë, janë grupi më i lartë irrezikut për ekstremizëm dhe dhunë të të gjitha llojeve. Ata janë në faza tranzicionale në jetën e tyre, si studentë, të sapodiplomuarit në kërkim për punë, kanë lënë ose janë duke lënë familjen e tyre amë dhe janë duke kërkuar për një familje të re dhe grupe të cilin do të identifikohen dhe e që për ta është e rëndësishme.

Disa nga ekstremistët e dhunshëm janë të motivuar nga dëshira për të qenë të rëndësishme dhe të luajnë një rol në diçka të rëndësishme. Kjo ndodh tek ata që nuk shohin rrugë tjera për një jetë kuptimplotë, ose ndjejnë se nuk kanë interes apo rol për të luajtur në shoqëritë e tyre.

Lidhjet personale janë gjithashtu shumë të rëndësishme për përhapjen e procesit të radikalizimit. Shumica e rekrutëve të ISIS apo Al Kaedës e kanë bërë këtë përmes miqve, dhe shumica e pjesës tjetër përmes familjes ose personave të tjerë që janë në kërkim të një rrugë domethënëse në jetë.

Një ekspert i njohur në fushën e ekstremizmit të dhunshëm ka konstatuar se "lagjia është shpesh çelësi" në lidhjen në mes të xhihadistëve, dhe sugjeroi: "Nëse doni të hulumtoni një grup, shikoni se ku njëri prej anëtarëve të grupit ushqehet ose shëtitet, në lagje ose në internet, dhe ka të ngjarë të gjeni anëtarët e tjerë"¹¹

Prandaj mund të themi se ekzistojnë një numër motivesh tashmë të njohura që ndikojnë tek personatë cilët i përqafojnë bindjet radikale ekstremiste, si:

- Motivi ideologjik;
- Materiale;
- Aventurier;
- Dëshira për lidhshmëri;
- Ambienti socio-kulturor.

4.2 Faktorët “Shtytës dhe Tërheqës” të radikalizmit dhe rreziqet për Kosovën

Faktorët që kontribuojnë në radikalizimin mund të kategorizohen në bazë të tëashtuquajturve faktorë. “shtytës” dhe “tërheqës” Faktorët ‘shtytës’ janë atafaktorë që shërbejnë për të shtytur një individ jashtë shoqërisë së tyre ose të shtetit dhe të ndikojnë që ata të bëhen të pambrojtur ndaj radikalizmit, ndërsa faktorët ‘tërheqës’ mund të përshkruhet si përpjekje aktive për të rekrutuar ose për t’i radikalizuar individët nga jashtë.

4.2.1 Faktorët shtytës

Në rastin e Kosovës faktorët kryesorë shtytës janë faktorët themelorë dhe strukturorë të tilla si sfidat/dobësitë ekonomike dhe sociale si dhe kapaciteti i mangët institucional dhe integriteti i tyre. Këto janë dobësi afatgjata që në shoqërinë kosovare shkaktojnë një gamë të gjerë të problemeve, duke mos u kufizuar vetëm në ekstremizmin e dhunshëm. Ndonëse Kosova është në përpjekje të vazhdueshme për të tejkaluar këto sfida, këto probleme mund të zgjasin për vite të tëra.

4.2.1.1 Faktorët ekonomik dhe social

Gjatë periudhës 15 vjeçare të pas luftës së vitit 1999, Kosova ka një nga normat më të ulëta të punësimit në Evropë. Punësimi i të rinjve është shumë i ulët, ndërsa, cilësia e sistemit arsimor publik nuk i përgatit të diplomuarit për tregun e punës. Mungesa e alternativave për orientimin e të rinjve në aktivitete tjera reprezentative ka ndikuar që të rinjtë në Kosovë të kenë më pak shanse për ta dëshmuar veten në fushën e sportit apo kampanjave të ndryshme dhe lëvizjeve me orientim global. Kësaj situatë i ka kontribuar edhe kufizimi i lëvizjes së lirë në vendet e BE-së dhe më gjerë, vende të cilat janë një shembull i të ardhmes së tyre.

¹¹ Scott Atran, *Talking to the Enemy: Faith, Brotherhood and the (Un) Making of Terrorists*, New York, 2010 (Kindle edition).

Prandaj, me gjithë përpjekjet e institucioneve shtetërore që të adresojnë të gjitha këto sfida, kryesisht ekonomike dhe sociale, ende ka ambient për zhvillim të faktorëve që shpien në ekstremizëm të dhunshëm, duke iu lënë hapësirë grupeve me prirje radikale që lehtësisht t'a shfrytëzojnë situatën për të rekrutuar përkrahës për kauzën e tyre.¹²

4.3.1.2 Kapaciteti dhe integriteti i ulët institucional

Përveç faktorëve ekonomik dhe social, sfidat me të cilat ballafaqohet Kosova, në veçanti ato në reformimin e administratës publike, luftimi i korrupsionit dhe rritja e integritetit të administratës publike janë faktorë tjerë shtytës që mund të shpien në ekstremizëm. Këta faktorë në hapësirën sociale të shtetit kanë potencial për të ndikuar negativisht tek të rinjtë, duke u shmangur nga institucionet tradicionale siç është familja dhe duke u inkurajuar disa nga ta për të parë realizimin e qëllimeve dhe synimeve të tyre jashtë shtetit. Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar një proces që synon reformimin e administratës publike, i cili synon adresimin e disa prej këtyre problemeve.

4.3.2 Faktorët tërheqës

Edhe pse, dobësitë dhe sfidat në Kosovë mund të luajë një rol në ekstremizëm dhe radikalizëm, ato sigurisht nuk mund të jenë i vetmi shpjegim për motivimin e një personi për t'u bashkuar me një lëvizje radikale. Mungesa e mundësive për të arritur qëllimet e tyre brenda vendit mund të ndikojë tek të rinjtë që ta lënë Kosovën, por kjo nuk mund të shpjegojë vendimin e tyre për t'u bashkuar p.sh. me ISIS duke dëmtuar të tjerët në shërbim të një ideologjie të dhunshme.

Paraja nuk është faktori kryesor shtytës, dëshira për të bërë diçka të rëndësishme dhe kuptimplotë, madje edhe me kosto të mëdha personale, është më e rëndësishme. Prandaj, kjo është dobësia ku rekrutuesit synojnë dhe ofrojnë propagandën e tyre dhe ku zërat radikalë mund të jenë efektive në tërheqjen e rekrutëve potencial në shërbim të tyre.

4.3.2.1 Prijësitradikalë

Disa imamë me prirje radikale, qoftë në Kosovë apo në rajonin e Ballkanit, kanë luajtur një rol në inkurajimin apo në mënyrë aktive rekrutimin e kosovarëve për të shkuar dhe për të luftuar në Siri. Përveç kësaj, disa nga ta kanë ndikuar edhe në zhvillimin e një ideologjie ekstremiste fetare gjatë këtyre viteve të fundit. Përderisa shumica e imamëve me prirje radikale kanë ndaluar çdo gjë që ata ishin duke bërë për të inkurajuar njerëzit për të luftuar në Siri, disa nga mbështetësit e ISIS dhe lëvizjet e tjera të dhunshme ekstremiste ende kërkojnë ata si autoritete fetare dhe qarkullojnë leksionet e tyre në internet.

Ndërsa që në një formë më të heshtur zhvillohet propagandë nga prijësit me motive etnike dhe politike për t'i kundërshtuar bashkëvendësit e vet që ndryshojnë nga ta. Thirrjet për vëllazëri historike dhe të gjakut dhe nxitja për të mos i shpëputur apo për t'i forcuar lidhjet tradicionale përbën anën tjerë të tematikës të cilën e shfrytëzojnë liderët shpirtërorë nacionalë dhe politik.

4.3.2.2 Radikalizimi online

¹² Qeveria e Republikës së Kosovës është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Kombëtar, përmes të cilit disa nga këto sfida synohet të adresohen.

Në kohën kur interneti zë një vend të rëndësishëm në inofmrimin e njerëzimit ka shumë mundësi që radikalizimi të bëhet online. Në botën e medieve sociale si: YouTube, Skype dhe Facebook, tweeter dhe shumë rrjeteve tjera të cilat përdoren për komunikim të gjerë, rekrutimi dhe influencimi i pikëpamjeve të caktuara është i mundur. Për momentin, ISIS ka qenë efektive në ofrimin e hapësirave në internet për të diskutuar dhe përsosur mesazhin e tyre dhe të kërkojë rekrutë në mënyrë efektive.

Komunitetet radikale apo ekstremiste dhe llogaritë mund të gjenden në Twitter ose Facebook, dhe të ofrojnë platforma efektive për të rekrutuar dhe drejtuar individët. Por, deri në çfarë mase kjo është efektive është e vështirë për tu thënë, sidoqoftë, radikalizimi në internet shërben si një mjet për të mbështetur një proces radikalizimi që zhvillohet mes miqve dhe kontakteve personale me persona të panjohur që i bashkohen të njëjtës ideologji.

Njerëzit e zakonshëm në Kosovë kanë ndjekur këto faqe dhe kanë postuar, po ashtu, përmbajtje ekstremiste nga ana e tyre.

4.4 Përmbledhje e analizave dhe vlerësimi i rrezikut nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm

Analizat e mësipërme na tregojnë se në lidhje me radikalizimin/ekstremizmin, është shumë e vështirë për të gjetur një përgjigje të qartë apo shpjegim për efektin e tij mbi individët dhe aftësinë e tij për të ndryshuar besimet fetare dhe ideologjike që shtyjnë individin për të vdekur apo të vvarë të tjerët. Edhe në Kosovë, sfida është e njëjtë si në vendet e tjera të botës perëndimore që kërkojnë luftimin e këtij fenomeni, për të identifikuar dhe për të kuptuar faktorët e rrezikut të cilët krijojnë kushtet ku radikalizimi mund të krijohet dhe të përhapet.

Për Kosovën kjo nënkupton adresimin e audiencës të synuar për radikalizimin, d.m.th. kryesisht djemtë e rinj. Në Kosovë, shumica e të rinjve që arrijnë moshëne të rriturve e gjejnë veten në një shoqëri dhe ambient ku është e vështirë për të gjetur një punë, ose të lëvizin lirshëm në Evropë për të kërkuar kushte më të mira. Në krye të kësaj pasigurie themelore mund të shtohedhe faktorë të tjerë, siç janë mundësitë për t'u angazhuar me komunitetet e tyre dhe me njëri-tjetrin, për të gjetur forume të hapura për diskutim dhe edukim në shkollë, në mënyrë që zëri i një rekrutuesi radikal në internet të mos jetë opinioni i vetëm për fenë, shoqërinë dhe shtetin.

Kërcënimi nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm që shpie në terrorizëm në Kosovë tani për tani është i ulët, megjithatë problemi me të cilin Republika e Kosovës ballafaqohet është të parandalojë ekstremizmin dhe radikalizimin në mesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Shqetësuese mbetet edhe përhapja dhe ndikimi i ideologjive ekstremiste me bazë fetare dhe nacionaliste të cilat bazohen në jo tolerancë, urrejtje ndërfaqetare (ndërsektare), ndërretnike dhe ngritje kundër sistemit demokratik dhe synimeve properëndimore të Republikës së Kosovës.

Edhe pse deri më tani, përveç disa rasteve të izoluara të dhunës kryesisht ndaj pjesëtarëve të 'moderuar' të islamit nuk ka pasur ndonjë rast i cili cenon drejtpërdrejt sigurinë e përgjithshme.

Për Kosovën është shqetësues fakti i pjesëmarrjes së numrit të konsiderueshëm të shtetasve të Republikës së Kosovës si vullnetarë në konfliktin jashtëterritorit të saj, sidomos në Siri. Andaj, ky trend i këtyre personave dhe grupeve që marrin pjesë në zonën e konflikteve jashtë vendit paralajmërojnë për një kërcënim real afatmesëm dhe afatgjatë nga këta individë dhe grupe.

Ekstremistët kanë për qëllim zbatimin e fesë në bazë të rregullave dhe ligjeve strikte sipas pikëpamjes së tyre të Sheriatit si dhe shpalljen e Kalifaiti si synim final. Ata me këtë rrezikojnë që të zhdukin mësimet fetare tradicionale jashtëzakonisht tolerante dhe racionale të Methhebit–Hanefi dhe t’i zëvendësojnë ato me mësimet tepër ekstreme e irracionale të doktrinë Selefiste.

Këto aktivitete i ushtrojnë përmes Shoqatave dhe organizatave Jo-qeveritare të ndryshme si vendore po ashtu edhe ndërkombëtare të cilat marrin për sipër edukimin e njerëzve në pikëpamje fetare, duke e përhapur doktrinën ekstremiste në Kosovë, gjë që nuk i përket traditës fetare të predikuar me shekuj në Kosovë.

Gjithashtu, në Kosovë vazhdojnë të jenë prezentë grupe ekstremiste serbe të cilat bashkëveprojnë me grupet kriminale dhe strukturat ilegale në veri të vendit, të cilat vazhdojnë të mbeten mjaft aktive këto grupe financohen nga veprimtaria e krimit të organizuar dhe strukturat ilegale që po ashtu financohen edhe nga shteti Serb. Qëllimi kryesor i këtyre grupeve është kundërshtimi i pavarësisë së Kosovës dhe pamundësimi i institucioneve të Kosovës që të shtrijnë legjitimitetin e plotë në atë pjesë të vendit. Aktivitete të këtyre grupeve janë propaganda dhe kërcënimet ndaj qytetarëve serb për tu mos u integruar në shoqërinë dhe institucionet e Kosovës dhe aktet e ndryshme të dhunës ndaj qytetarëve shqiptar, institucioneve dhe prezencës vendore dhe ndërkombëtare në atë pjesë të vendit.

4.5 SWOT Analiza

Përparësitë	Dobësitë
<ul style="list-style-type: none"> Kosova ka një rini të shëndoshë 	<ul style="list-style-type: none"> Niveli i lartë i papunësisë si resurse të limituara financiare për të adresuar këtë problem
<ul style="list-style-type: none"> Shoqëria kosovare ka një lidhje të fortë në mes vete dhe Familja tradicionalisht përbënë një institucion të rëndësishëm në shoqërinë kosovare 	<ul style="list-style-type: none"> Roli i familjes mund të dobësohet me kalimin e kohës
<ul style="list-style-type: none"> Kosova ka të gjitha institucionet e themeluara që mund të trajtojnë parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmin e dhunshëm 	<ul style="list-style-type: none"> Një shkallë e lartë e pakënaqësisë së qytetarëve dhe nivel i ulët i besimit me punën e shumë autoriteteve publike (korrupsioni)
<ul style="list-style-type: none"> Ekziston një tolerancë e lartë fetare në mes të komuniteteve fetare në Kosovë 	<ul style="list-style-type: none"> Shërbimet sociale, shëndetësore, përkrahja sociale, arsimit cilësor duhet të përmirësohen më tej
<ul style="list-style-type: none"> Kosova tradicionalisht ka kultivuar një islam tradicional i cili nuk ka qenë i identifikuar me rrymat radikale 	<ul style="list-style-type: none"> Një pjesë e popullsisë pakicë serbe që jeton në pjesën veriore të Kosovës ende nuk është integruar plotësisht në jetën institucionale

<ul style="list-style-type: none"> Kosova ka një bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar 	<ul style="list-style-type: none"> Mbetet ende dobësi bashkëpunimi me vendet që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.
	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistimi i një grupi të kufizuar të prijësve që kanë prirje radikale
	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i rrjeteve sociale dhe formave tjera të komunikimit elektronik nga grupet radikale me qëllim të rekrutimit – që e bënë të vështirë kontrollimin e tyre duke ndikuar në radikalizimin online. Për më tepër ekziston një mungesë e kapaciteteve për ti përcjellë dhe trajtuar ato.
Mundësitë	Rreziqet
<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi me bashkësitë fetare për të promovuar tolerancën dhe kundër ekstremizmin 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e një numri të qytetarëve të Kosovës në Luftërat e huaja dhe kthimi i tyre në Kosovë
<ul style="list-style-type: none"> Ekzistojnë politika qeveritare ekzistuese në kuadër të të cilave mund të adresohen edhe çështja e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm 	<ul style="list-style-type: none"> Trajtimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm duhet të jetë i kujdesshëm, në mënyrë që mos të prodhojë kundërefekte
<ul style="list-style-type: none"> Shumica e rinisë kosovare është e aftë të përdor rrjetet sociale dhe në këtë mënyrë mund të shfrytëzohet për të promovuar tolerancën dhe kundër ekstremizmin 	<ul style="list-style-type: none"> Ekziston rreziku që Kosova të jetë cak i sulmeve terroriste
<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të koordinuar aktivitetet duke shfrytëzuar edhe përvojën e vendeve tjera 	<ul style="list-style-type: none"> Masat e ndërmarra me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit mund të cenojnë disa nga liritë dhe të drejtat personale të tilla si liria e shprehjes, medias etj.
<ul style="list-style-type: none"> Shfrytëzimi i fondeve të BE-së dhe organizatave tjera ndërkombëtare për të adresuar disa nga sfidat me të cilat përballlet Kosova në këtë fushë 	

5 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Mbi bazën e analizave të kryera më sipër, strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020 do të fokusohet në realizimin e katër objektivave strategjike dhe një numri më të madh të objektivave/masave specifike të cilat synohet arrihen për periudhën 2015-2020. Këto objektiva strategjike dhe masa specifike të parapara me këtë strategji do të synohet të arrihen përmes aktiviteteve specifike të cilat do të jenë pjesë e planit të veprimit për implementimin e strategjisë 2015-2020. Arritja e këtyre objektivave strategjike do të ketë një ndërveprim edhe me programet ekzistuese duke përfshirë edhe strategjitë dhe politikat ekzistuese të Qeverisë si dhe planet përkatëse për implementimin e strategjive ekzistuese. Kjo strategji do të fokusohet në katër objektiva strategjike si në vijim:

- ✓ **Identifikimi i hershëm- i shkaqeve, faktorëve dhe grupeve të targetuara**
- ✓ **Parandalimi- i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm**
- ✓ **Intervenimi – me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm**
- ✓ **De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar**

5.1 Identifikimi i hershëm i shkaqeve, faktorëve, grupeve të targetuara dhe mënyrave të radikalizmit

Përmes këtij objektivi strategjik synohet që së bashku me akterët relevant, qeveritar dhe jo qeveritar si dhe me komunitetin të krijohen praktika të bashkëpunimit me qëllim identifikimin me kohë të shkaqeve, faktorëve, grupeve tëtargetuarasi dhe mënyrave dhe metodave të radikalizmit.Rol të rëndësishëm në identifikimin e hershëm duhet të kenë: prindërit, shokët (e lagjes dhe shkollës), mësuesit, pedagogët dhe psikologët, punëtorët social, punëtorët e zyrave të punësimit etj.Bashkëpunimi i institucioneve të nivelit qendror si MASHT, MPB, MPMS, MKRS, me shkollat, komunitetin, bashkësitë fetare, OJQ-të dhe shoqërinë civile në përgjithësi është esencial për identifikimin e hershëm të faktorëve të radikalizimit, grupeve të targetuara si dhe mënyrave dhe metodave të radikalizmit. Në identifikimin e hershëm të këtyre faktorëve rol kyç duhet të luajnë edhe institucionetdhe mekanizmat përkatëse të sigurisë, duke përfshirë AKI-në, Policinë, NJIF-K, si dhe mekanizmat tjerë.

Objektivat/Masat specifike në funksion të realizimit të kësaj objektivave përfshijnë:

- ✓ **Identifikimin e popullsisë së targetuar për radikalizim;**
- ✓ **Identifikimin e hershëm të faktorëve që ndikojnë në radikalizim;**
- ✓ **Rritja e vetëdijes së institucioneve dhe bashkëpunimi me komunitetin;**

✓ **Ngritja e kapaciteteve të institucioneve me qëllim të identifikimit të hershëm të faktorëve dhe proceseve të radikalizmit;**

Këto objektiva specifike/masa do të shëndrrohen në aktivitete konkrete përmes planit për implementimin e strategjisë, i cili do të miratohet si një dokument shtesë për implementimin e këtij dokumenti strategjik për periudhën 2015 – 2018, me mundësi rifreskimi në baza vjetore. Në kuadër të këtyre masave do të ndërmerren aktivitete në të gjithë sektorët qeveritarë të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë në identifikimin e hershëm, duke përfshirë aktivitetet në vazhdim:

1. Organizimin e një trajnimit të detyrueshëm për zyrtarët komunal, mësuesit, menaxhmentin e shkollave si dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit për të identifikuar të rinjtë që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla (*Realizimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim në mes të MASHT, MPB, MAPL, MPMS, Komunave, Policisë së Kosovës etj. Si dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.*)
2. Krijimin e një ekipi të analistëve në nivel nacional për të mbledhur informacion mbi tendencat e radikalizimit në gjithë Kosovën (duke përfshirë rajonet/lokacionet më të prekura, moshën e synuar, demografinë etnike dhe të tjera, rekrutuesit dhe organizatat mbështetëse, narrativët e rekrutimit dhe metodat e përdorura nga ana e tyre), si dhe monitorimin e tyre për zhvillimet e reja, dhe përdorimi i këtij informacioni për të përshtatur veprimet parandaluese. Kryerja e hulumtimeve specifike në shkolla si dhe me opinionin publik do të jetë pjesë përbërëse e këtij aktiviteti. (*Realizimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim në mes të ZKM, MASHT, MPB, MPMS, Komunave, Policisë së Kosovës, AKI-së, NJIF-K etj. si dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.*)
3. Organizimi i takimeve të rregullta në mes të institucioneve publike me komunitetin, shkollat, bashkësitë fetare duke përdorur rrjetet dhe mekanizmat ekzistuese. (*Realizimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet nga institucionet në vazhdim MASHT, MPB, MPMS, Komunave, Policisë së Kosovës, Bashkësive Fetare, OJQ-ve etj.*)
4. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në identifikimin e faktorëve të radikalizmit, në veçanti në identifikimin

Identifikimi i hershëm i individëve dhe grupeve/shtresave që janë potencial për tu shfrytëzuar nga individët/grupet që janë bartës të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizëm është kyç për realizimin e suksesshëm të objektivave të kësaj strategjie. Prandaj, në kuadër të identifikimit të hershëm të radikalizmit do të punohet në sektorët kyç, arsimit, shërbimet sociale, siguria, inteligjenca, administrata publike etj.

Në kuadër të identifikimit të faktorëve që ndikojnë në radikalizëm, do të ndërmerren aktivitete shtesë në bashkëpunim me komunitetin, bashkësitë fetare, si dhe nga vetë institucionet shtetërore me qëllim të identifikimit të personave dhe organizatave që ushtrojnë ndikim në radikalizimin e popullsisë, identifikimin e vendeve/objekteve ku zhvillohen ide ekstremiste apo radikale; identifikimin e literaturës që konsiderohet me përmbajtje radikale dhe ekstremiste, identifikimin e web faqeve në internet të cilat propagandojnë ide radikale/ekstremiste. Kur jemi tek identifikimi i shkaqeve të radikalizmit, do të punohet edhe nëpërmjet intervistimit të personave të arrestuar apo personave të kthyer nga konflikti, matjes së perceptimit të qytetarëve etj.

Përveç kësaj, një vlerësim i gjendjes së ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm në Republikën e Kosovës do të jetë i vazhdueshëm. Kjo do të mund të bëhet përmes kryerjes së hulumtimeve mbi shkaqet e radikalizmit, kuptimit të narrativëve dhe ideologjisë së individëve dhe grupeve ekstremiste, identifikimi i mënyrës së rekrutimit, identifikimit të faktorëve shtytës duke përfshirë ato ekonomike, sociale dhe politike që mund të ndikojnë në rritjen e ekstremizmit dhe radikalizmit, identifikimi i grupeve ekstremiste dhe radikale dhe përcjellja e aktiviteteve të tyre, identifikimi dhe përcjellja e formave të ndryshme të influencës globale që ndikojnë në radikalizmin e individëve apo grupeve të caktuara etj.

Kjo fazë, pra identifikimi i hershëm nuk nënkupton edhe luftimin e drejtpërdrejtë të shkaktarëve, disa prej të cilëve janë objekt i trajtimit edhe të strategjive dhe politikave tjera.

5.2 Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm

Procesi i parandalimit do të jetë i lidhur ngushtëme identifikimin e hershëm të faktorëve, shkaqeve dhe personave/grupeve të targetuara. Koordinimi i aktiviteteve në mes të institucioneve përgjegjëse qeveritare, bashkësive fetare, komunitetit në përgjithësi si dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë do të mundësojë që problemet e identifikuar sa i përket radikalizmit të adresohen përmes masave parandaluese.

Në qendër të kësaj objektive strategjike do të jetë ofrimi i informatave të përgjithshme, të nevojshme dhe të drejta për pasojat që bartë për individin dhe rrethin ndjekja e rrugës së radikalizmit dhe eventualisht veprimi qoftë brenda apo jashtë Kosovës. Në trajtimin e shkaktarëve të radikalizmit rol të rëndësishëm do të ketë ofrimi i alternativave atraktive siç janë: mundësia për shkollim, ofrimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe sportive, mundësia për angazhim në trajnime dhe punësim etj., të cilat do të synohet të realizohen përmes programeve ekzistuese në kuadër të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, si dhe përmes masave të reja që do të implementohen si masa për adresimin e kësaj objektive strategjike.

Objektivat/Masat specifike në funksion të realizimit të kësaj objektive do të përfshijnë:

- Rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve të komunitetit - familjes, shkollave, administratës komunale, bizneseve lokale, kujdesit shëndetësor dhe punonjësve socialë, zyrtarëve tëzbatimit të ligjit, zyrtarët fetarë, dhe shoqërisë civile - në lidhje me rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe nxitjes së bashkëpunimit për të luftuar atë.

- Rritja e kapacitetit të aktorëve /hisedarëve: qeverisë, sektorit të arsimit, autoriteteve të zbatimit të ligjit, bizneseve lokale, shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare - të ndërmarrë aktivitete kunër ekstremizmit të dhunshëm. Rritja e mbështetjes për të rinjtë duke përmirësuar arsimin, mundësitë dhe trajnime për punë, mundësi punësimi si duke ofruar vende të sigurta për të diskutuar çështje të vështira.
- Udhëheqja e një fushatë efektive kundër- mesazheve që ndikojnë në radikalizëm, përmes të cilës do të ndikohet tek të rinjtë të heqin dorë nga mbështetja e pikëpamjeve ekstremiste dhe taktikave të dhunshme.
- Inkorporimi i aktiviteteve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në programet ekzistuese mbështetëse dhe iniciativat e komunitetit.
- Zhvillimi i një initiative rajonale me qëllim të rritjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore, komunave (posaçërisht atyre përgjatë vijave kufitare) dhe strukturave tjera (p.sh. rrjeteve të grave, rinisë, etj.)
- Krijimin e një plani strategjik të komunikimit të institucioneve me qytetarët me qëllim të vetëdijesimit nga rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit.

Këto objektiva specifike/masa do të shëndrrohen në aktivitete konkrete përmes planit për implementimin e strategjisë, i cili do të miratohet si një dokument shtesë për implementimin e këtij dokumenti strategjik për periudhën 2015 – 2018, me mundësi rifreskimi në baza vjetore. Në kuadër të këtyre masave do të ndërmerren aktivitete në të gjithë sektorët qeveritarë të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë në parandalime e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, duke përfshirë aktivitetet në vazhdim:

1. Krijimin e një plani strategjik të komunikimit duke përfshirë kampanja publike, përdorimin e medias dhe rrjeteve sociale, ligjëratat publike, sesionet mbi sigurinë publike në shkolla etj. për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe për të treguar pse ekstremizmi i dhunshëm është i gabuar dhe si rekrutuesit e bëjnë rekrutimin e të rinjve. Ky plan strategjik do të përfshijë figura të besueshme publike duke përfshirë edhe prijës fetar, sportistë të njohur, këngëtar, individ që janë larguar nga radikalizmi dhe anëtarë të familjeve të tyre, përfaqësues të shoqërisë civile etj. *(Realizimi i këtyre aktiviteteve do të bëhet në bashkëpunim dhe koordinim në mes të ZKM, MASHT, MPB, MPMS, MKRS, Policisë së Kosovës, Bashkësive Fetare, OJQ-ve, ekspertëve të fushës etj. si dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.)*
2. Ofrimin e trajnimeve për gazetarët dhe studiuesit që mbulojnë ekstremizmin e dhunshëm se si duhet trajtuar këtë çështje në mënyrë objektive dhe pa krijuar ndjeshmëri. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet ZKM, MPB, MASHT, MKRS, Bashkësive Fetare, OJQ-ve ekspertëve të fushës etj. Dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.)*
3. Përgatitjen e një broshure/pamfleti për të rinjtë dhe komunitetin e cila mund të shpërndahet në sesionet e trajnimit, fushatave të informimit publik, etj. Me të cilën theksohen në mënyrë të qartë se çka është ekstremizmi dhe radikalizmi, si radikalizohen

njerëzit, veçanërisht të rinjtë, cilat janë taktikat dhe metodat e rekrutimit të tyre, dhe se si të rinjtë mund ti identifikojnë këto taktika dhe të mbrojnë veten e tyre. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet ZKM, MASHT, MKRS, MPB, Bashkësive Fetare, OJQ-ve ekspertëve të fushës etj. Dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.)*

4. Bashkëpunimin me bashkësitë/komunitetin fetar që ato të përfshijnë ligjërata/leksione apo predikime fetare që kundërshtojnë/dekurajojnë dhunën dhe promovojnë harmoninë ndërfitare; *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bashkësive Fetare)*
5. Krijimin e një ekipi/komisioni për të shqyrtuar përmbajtjen fetare në internet dhe nëse është e nevojshme angazhimi i përkthyesve për të përkthyer përmbajtje të moderuar fetare të qasshme në internet në gjuhën shqipe. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bashkësive Fetare, me pjesëmarrës ekspertë të fushës që do të analizojnë përmbajtjen sa fetare në internet ndërsa do të shihet mundësia e përkrahjes edhe të donatorëve në implementimin e këtij aktiviteti).*
6. Ofrimin e granteve për bizneset lokale, qendrat rinore, OJQ-të për të iniciuar programe rritjen e mundësisë së qasjes së të rinjve në sport ose angazhimit në komunitetin, biznes, mundësi të vullnetarizmit për t'u dhënë atyre ndjenjën e qëllimit dhe vendit që i përkasin; *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Institucioneve Publike duke përfshirë MKRS, MASHT, MPMS, Komunat, OJQ-ve etj. Dhe me përkrahjen edhe të partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.)*
7. Krijimin e hapësirave të sigurta në shkolla për nxënësit që të bëjnë pyetje privatisht rreth të çështjeve të ndjeshme sociale ose identitetit me praktikues trajnuar (pedagog, psikolog etj.) të cilët mund ti ndihmojnë ata. Pjesë e këtij aktiviteti duhet të jetë përmirësimi dhe kompletimi i vazhdueshëm i shërbimit psikologjik dhe pedagogjik në shkollat me nevojë, në veçanti duke ju kushtuar rëndësi zonave më të targetuara nga radikalizmi. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Institucioneve Publike duke përfshirë Qeverinë, MASHT, Komunat, Drejtoritë Komunale të Arsimit, komunitetin e prindërve etj.)*
8. Rishikimin e kurrikulës arsimore historike, edukatës qytetare dhe lëndëve tjera përkatëse për të theksuar rëndësinë historike të tolerancës ndërfitare në Kosovë, dhe për ti edukuar të rinjtë se çfarë do të thotë të jesh një qytetar i mirë; ky aktivitet duhet të përfshijë po ashtu edhe rishikimin e teksteve mësimore dhe ri-trajnimin e mësimitdhënësve sipas nevojës; *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Institucioneve*

Publike duke përfshirë Qeverinë, MASHT, Komunitat, Drejtoritë Komunale të Arsimit, komunitetin e prindërve, Bashkësitë Fetare, ekspertët e fushës etj.)

9. Rritjen e sigurisë përreth të burgosurve për aktivitete që lidhen me ekstremizëm për të parandaluar ata nga rekrutimi i të burgosurve të tjerë. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet nga Ministria e Drejtësisë (Shërbimi Korrektues) me përfshirjen edhe të ekspertëve që njohin fushën e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.)*
10. Vlerësimi i legjislacionit ekzistues dhe atij në proces me qëllim të adresimit parandalues të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Drejtësisë, Ministrinë e Linjës dhe me përfshirjen edhe të ekspertëve që njohin fushën e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm.)*

Përmes aktiviteteve specifike të cilat do të përfshihen në planin implementues të strategjisë do të rritet ndërveprimi në mes të institucioneve dhe mekanizmeve kyç në identifikimin dhe minimizimin e faktorëve dhe shkaqeve të cilat mund të qojnë në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për paraqitjen dhe përhapjen e ideve radikale që qojnë në përdorimin e dhunës. Një bashkëpunimi ndërinstitucional për koordinimin e aktiviteteve si dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar do të jetë kyç në realizimin e suksesshëm të këtyre masave.

Bashkëpunimi me bashkësitë fetare në veçanti me imamë kredibil, me përfaqësues të shoqërisë civile për të udhëhequr një fushatë vetëdijësuese për kërcënimet që vijnë nga radikalizmi i dhunshëm, do të jetë pjesë e masave të cilat do të ndërmerren me qëllim të adresimit të kësaj objektiviteti strategjike. Përmes përkrahjes së aktiviteteve konkrete do të kontribuohet në zhvillimin e dialogut publik në mediet e shkruara dhe elektronike, si dhe në rrjetet sociale, duke përfshirë tematika që kanë të bëjnë me rolin e religjionit në shoqëritë sekulare duke inkurajuar tolerancë dhe respekt për pikëpamjet e ndryshme.

Në kuadër të këtyre masave do të ndërmerren aktivitete specifike në sektorët kyç duke përfshirë: sektorin e arsimit dhe institucionet edukativo-arsimore, përfshirë analizimin e programeve dhe projekteve ekzistuese në kuadër të arsimit fillor dhe të mesëm me qëllim të promovimit të tolerancës, rritjen e mendimit kritik, ofrimin e njohurive globale mbi religjionin ngritjen e kapaciteteve dhe funksionalizimin e mekanizmeve brenda institucional të shkollave për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, si dhe shtimin e masave të sigurisë në shkolla. Po ashtu promovimi dhe përkrahja e aktiviteteve sportive, kulturore, rekreative me grupe të rrezikuara nga radikalizmi do të jenë pjesë e masave parandaluese.

Rritja e perspektivës ekonomike, punësimit dhe mirëqenies sociale për qytetarët e Republikës së Kosovës do të jenë po ashtu një ndërmarrje me qëllim të adresimit të faktorëve shtytës që ndikojnë në radikalizimin e popullsisë. Në kuadër të planit të veprimit të strategjisë do të parashihen aktivitete që nxisin punësimin, zhvillimin e biznesit dhe po ashtu të ndërldhura me arsimimin e të rinjve, punësimin dhe përkrahjen sociale për shtresat e prekura. Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim do të adresojë disa nga këto çështje. Po ashtu edhe në kuadër

të strategjive dhe politikave sektoriale të Arsimit, Rinisë, punësimit do të synohet të realizohen këto masa.

5.3 Intervenimi – me qëllim të parandalimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm

Kjo objektivë strategjike ka për synim që të adresoj një bashkëpunim më të madh me komunitetin, autoritetet e zbatimit të ligjit dhe institucionet tjera për të adresuar rreziqet potenciale që vijnë nga individët dhe grupet e radikalizuara. Aktivitetet dhe masat në kuadër të kësaj objektive nuk kanë për qëllim të dyfishojnë apo të zëvendësojnë masat që janë të parapara me strategjinë kundër terrorizmit. Qëllimi kryesor i kësaj objektive është që të ndihmohen individët dhe grupet e rrezikuara nga radikalizmi.

Objektivat/Masat specifike në funksion të realizimit të kësaj objektive përfshijnë:

- Identifikimi i individëve të cilët janë duke treguar shenja të të qenit të radikalizuar të dhunshëm dhe ndërhyrja para se ata të shkaktojnë dëm në veten apo të tjerët.
- Krijimi i një partneriteti me komunitetet lokale për të krijuar mekanizmat e reagimit me bazë komunitare që mund të kryejnë intervenime për individët që ekspozojnë shenjat e e radikalizmit të dhunshëm;
- Ofrimi i trajnimeve, financimit dhe asistencë për individët që marrin pjesë në mekanizmat e duhur të reagimit në nivel komuniteti për ndërhyrje.
- Ndërtimi i besimit në mes anëtarëve të komunitetit, punonjësve socialë dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit, dhe të sigurojë bashkëpunimin midis praktikuesve lokal dhe autoriteteve qendrore, për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe për të mbrojtur individët në rrezik.
- Sinkronizimi i masave të intervenimit me nismat e tjera të sigurisë publike dhe përpjekjet rajonale kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Këto masa do të shëndrrohen në aktivitete konkrete përmes planit për implementimin e strategjisë, i cili do të miratohet si një dokument shtesë për implementimin e këtij dokumenti strategjik për periudhën 2015 – 2018, me mundësi rifreskimi në baza vjetore. Në kuadër të këtyre masave do të ndërmerren aktivitete në të gjithë sektorët qeveritarë të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë duke përfshirë aktivitetet në vazhdim:

1. Krijimi i një mekanizmi referues (ekipeve të shpejta të reagimit) në komunitetet nëpër Kosovë të përbërë nga psikologë të trajnuar, punonjës socialë, zyrtarët fetarë, dhe të zbatimit të ligjit të cilët mund të punojnë me personat që janë radikalizuar në përpjekje për të parandaluar ata nga dëmtimi i vetes dhe të tjerëve. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet MASHT, MPB, MPMS, MKRS, MSH, Policisë së Kosovës, si dhe me përfshirjen e ekspertëve përkatës dhe përfaqësuesve të bashkësive fetare.)*
2. Krijimi i një linjë telefonike për banorët për të thirrur dhe për të raportuar në mënyrë anonime lidhur me organizatat/individët që mbështesin idetë ekstremiste në komunitet (duke përfshirë rekrutimin, financimin, viktimat, etj). *(Realizimi i këtij aktiviteti do të*

bëhet në koordinim ndërmjet Institucioneve Publike duke përfshirë Qeverinë, MPB-në, Policinë, AKI-në dhe institucionet tjera.)

3. Përkrahja e bashkëpunimit në mes të organizatave rinore dhe këshillave të nxënësve me institucioneve edukative, përmes trajnimeve, punëtorive, seminareve, konferencave etj. Si dhe mbështetja e aktivitete kulturore dhe sportive përmes projekteve konkrete nga organizatat rinore me temë luftimin e narratives së grupeve ekstremiste. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet IMKRS-së MASHT dhe institucionet tjera.)*

5.4 De-radikalizimi dhe riintegrimi - i personave të radikalizuar

Po ashtu de-radikalizimi është i lidhur me objektivat e lartshënuara. Kjo fazë do të ishte si reagim ndaj mos arritjes së identifikimit dhe parandalimit. Pra, në këtë fazë kemi të bëjmë me persona që tashmë janë në një fazë të avancuar të radikalizimit dhe janë të gatshëm të ndërmarrin hapa si jashtë ashtu edhe brenda Kosovës për arsye të ndryshme. Në këtë fazë rol të rëndësishëm do të kenë organizimet fetare apo të ndonjë karakteri tjetër pjesë e të cilit mund të ndihen më afër personat e radikalizuar. Po ashtu, varësisht prej moshës dhe profilit personal ose edhe përgatitjes apo prirjes duhet të ofrohen alternative që do të ndikonin në zvogëlimin dhe eliminimin e mundësisë për veprime jashtë ligjore.

Kjo fazë duhet të hulumtohet ende sikurse edhe tjerat për veprimet që nevojitet të merren në ri-integrimin e personave të radikalizuar. Duhet të kihet parasysh se tashmë Kosova ka ligje në fuqi, duke përfshirë atë për pjesëmarrjen në luftërat jashtë vendit. Ri-integrimi nuk interferon në këtë pikë, mirëpo duhet të shihen mundësitë e bashkëpunimit. Kjo mund të bëhet sidomos me fëmijët që tashmë kanë shkuar me njërin apo dy prindërit jashtë vendit për të marrë pjesë në luftërat të huaja. Mirëpogjithashtu riintegrimi duhet të fokusohet edhe më shumë te personat apo grupet që janë të indentifikuar brenda Kosovës, në cilëndo fazë të lartë cekur dhe nuk kanë bërë shkelje ligjore, sepse pastaj ata janë objekt i ligjeve në fuqi. Riintegrimi i personave potencialisht të radikalizuar ose që janë në fazë të radikalizmit duhet të jetë proces gjithëpërfshirës dhe konkret. Këtu rol kyç do të ketë: MPMS, MKRS, MASHT, Komunitat, etj.

Objektivat/Masat specifike në funksion të realizimit të kësaj objektivë përfshijnë:

- Ofrimi indihmës për individët e radikalizuar që të largohen nga ideologjia radikale/ekstremiste dhe të heqin dorë nga dhuna.
- Vlerësimi i rrezikut që vjen nga individët e kthyer si luftëtarë terrorist nga konfliktet e huajaduke përfshirë alternativa në paraburgim ku është e përshtatshme duke përdorur mbështetje psikologjike /psiko-sociale për të ndihmuar ata të riintegrohen në shoqëri.
- Rritja e ndërgjegjësimit brenda sistemit korrektues mbi rrezikun që vjen nga terroristët burgosur apo të dyshuarve për terrorizëm dhe ndërtimi i kapaciteteve të sistemit për të rehabilituar të burgosurit e tillë.

Edhe këto masa do të shëndrrohen në aktivitete konkrete përmes planit për implementimin e strategjisë, i cili do të miratohet sinjë dokument shtesë për implementimin e këtij dokumenti strategjik për periudhën 2015 – 2018, me mundësi rirrefreskimi në baza vjetore. Në kuadër të këtyre

masave/objektivave specifike do të ndërmerren aktivitete në sektorët qeveritarë *MD-së, MASHT, MPMS, MKRS*, të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë duke përfshirë aktivitetet në vazhdim:

1. Ofrimi i këshillimit psikologjik dhe fetar për të burgosurit për veprimtari të paligjshme lidhur me ekstremizmin, si dhe mbështetje sociale për familjet e tyre; *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet MD-së, MASHT, MPMS, MKRS, si dhe me përfshirjen e ekspertëve përkatës(psikologëve) dhe përfaqësuesve të bashkësive fetare.)*
2. Zhvillimi i programeve të reja të punësimit ose metodave tjera të riintegrit të individëve të de-radikalizuar në shoqëri. *(Realizimi i këtij aktiviteti do të bëhet në koordinim ndërmjet Qeverisë, MPMS, MKRS, si dhe me përkrahjen e partnerëve dhe donatorëve ndërkombëtar.)*

6. ALTERNATIVAT E SHQYRTUARA DHE QASJA E REKOMANDUAR PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMIT

Siç u potencua edhe në analizat e mësipërme ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi përbënë një rrezik potencial për sigurinë nacionale. Qeveria e Republikës së Kosovës ka analizuar të gjitha opsionet e mundshme për adresimin e këtij problemi. Mos trajtimi në kohë i këtij problemi do të mund të shkaktonte një rritje të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Duke pas parasysh që problemi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm nuk është një problem vetëm brenda kufijve të Republikës së Kosovës, por është një problem me shtrirje globale, kjo e bënë edhe më të domosdoshëm një intervenim në kohë, me qëllim të parandalimit të rreziqeve dhe parandalimit të radikalizmit të dhunshëm. Prandaj, mos adresimi i këtij problemi nuk përbënë opsion për Kosovën.

Njëri nga opsionet e mundshme për adresimin ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm do të ishte trajtimi në kuadër të politikave dhe strategjive ekzistuese, p.sh. në kuadër të Strategjisë Kombëtare e Republikë së Kosovës për Parandalim të Krimin dhe Planit të Veprimit 2013 – 2017; Strategjisë Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit 2012 – 2017; Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016; Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe planit të veprimit; Strategjisë Kosovare për Rininë 2013 - 2017 dhe Planit të Veprimit 2013 - 2015 (SKPVR) si dhe strategjive tjera në sektor të ndryshëm por, pa hartuar një dokument të veçantë strategjik që trajton vetëm radikalizmin. Secili nga opsionet e trajtimit të problemit ka përparësitë dhe të metat e veta, dhe edhe ky opsion si dobësi do të kishte që si i tillë nuk do të ishte si prioritet strategjik, por në kuadër të prioriteteve ekzistuese të Kosovës, duke përfshirë masa shtesë. Qeveria e Republikës së Kosovës është e interesuar që të mbulojë fushat kyçe me strategji sektoriale, sidoqoftë, ky proces është duke vazhduar, prandaj, deri në adresimin e fushave kyçe me strategji sektoriale çështja e parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm nuk preferohet të adresohet vetëm në kuadër të politikave ekzistuese, kjo për shkak të rëndësisë dhe prioritetit të saj.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës mbi bazën e analizave të kryera më sipër ka ardhur në përfundim që çështja e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm duhet të adresohet përmes një qasje të strukturuar e cila do të përfshijë të gjithë akterët e brendshëm institucional, shoqërinë civile, bashkësitë fetare dhe etnike dhe partnerët ndërkombëtar. Vetë hartimi i strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm përbënë një qasje strategjike e cila do të reflektojë edhe në angazhimin institucional dhe të akterëve të tjerë për adresimin e problemit në mënyrën e duhur, duke i kushtuar një rëndësi prioritare në kuadër të politikave qeveritare.

Analizat kanë treguar se problemi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm kërkon një qasje të veçantë dhe përveç politikave ekzistuese të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës është duke implementuar në ofrimin e arsimit cilësor, rritjen e punësimit, përkrahjes sociale, si dhe

aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive, duhet të ndërmerren edhe aktivitete shtesë në implementimin e të cilave patjetër duhet të përfshihen edhe bashkësitë fetare, shoqëria civile, partnerët ndërkombëtarë dhe në përgjithësi komuniteti.

Përveç kësaj, edhe në kuadër të politikave ekzistuese, duke përfshirë masat dhe aktiviteteve në kuadër të strategjive ekzistuese që janë në fuqi në Republikën e Kosovës dhe planeve për implementimin e tyre do të inkorporohen edhe aktivitete dhe masa shtesë me qëllim të adresimit të koordinuar të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Duke pasur parasysh mekanizmat ekzistues dhe institucional si dhe resurset implementuese, kjo do të mundësoj që masat kundër radikalizmit të. Dokumente strategjike ekzistues në kuadër të të cilave do të mund të implementoheshin aktivitete shtesë që janë të ndërlidhura me parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm janë:

- Strategjia Kosovare për Rininë 2013 - 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 - 2015 (SKPVR)
- Strategjia e Komunikimit në Sektorin e Arsimit;
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016;
- Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe plani i veprimit;
- Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale në Kosovë 2013-2017;
- Strategji e Aftësimit Profesional (ky dokument ka skaduar në vitin 2014....në rast se pritet të rihartohet)
- Strategjia për Migrim dhe plani i veprimit 2013 – 2018;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalim të Krimit dhe Plani i Veprimit 2013 – 2017;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit 2012 – 2017;
- Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016;
- Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2014 – 2016;

Po ashtu, trajtimi i parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit do të mund të trajtohet përmes masave në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik 2015 – 2018 dhe dokumenteve tjera strategjike të cilat janë në proces të hartimit apo përditësimit. Edhe masat ligjore që ndërlidhen me këtë fushën e që janë në proces do të jenë një faktor parandalues për ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se mostrajtimi i fenomenit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm në mënyrë të duhur dhe strukturore paraqet një rrezik për sigurinë Kombëtare të Republikës së Kosovës, prandaj trajtimi i problemit me qëllim të parandalimit nuk ka alternativë. Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm të trajtohet me strategji të veçantë.

7. HARTIMI, RISHIKIMI, MIRATIMI, ZBATIMI DHE MEKANIZMAT MONITORUES TË STRATEGJISË

7.1 E përgjithshme

Miratimi i Strategjisë Kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 – 2020 është kompetence e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo strategji hartohet dhe rishikohet nga grupi punues qeveritar i themeluar me vendim të Kryeministrit. Hartimi dhe rishikimi i saj bëhet mbi bazën e një analize paraprake të rreziqeve potenciale, me qëllim të adresimit të drejtë të fenomenit të ekstremizmit dhe radikalizmit. Ky dokument strategjik është një dokument politikash, prandaj hartimi, rishikimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i tij është një funksion i vazhdueshëm. Procesi i hartimit dhe rishikimit të strategjisë është një proces transparent dhe do të bazohet në një raportim të rregullt të institucioneve të obliguara dhe me miratim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

7.2 Plani i veprimit për implementimin e strategjisë

Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2015 – 2020, do të shoqërohet edhe me një plan veprimi për implementimin e strategjisë për periudhën 2015 - 2018, i cili në vete përmban një sërë masash dhe aktiviteteve, të bazuara në objektivat strategjike të përcaktuara me këtë strategji. Aktivitetet e planit të veprimit do të rishikohen në baza të rregullta vjetore, bazuar në raportimet e përmbushjes nga ana e institucioneve përgjegjëse për implementimin e tyre.

7.3 Implementimi, monitorimi dhe mekanizmat monitorues për implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit

Zyra e Kryeministrit mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm si dhe Planit të Veprimit. Zyra e Kryeministrit kryeson Grupin Punues Qeveritar për hartimin e strategjisë dhe në të njëjtën kohë do të kryesojë edhe Sekretariatit dhe Grupin Punues Teknik të cilat do të themelohen për mbikëqyrjen e implementimit të Strategjisë Kombëtare 2015-2020 dhe Planin e Veprimit 2015-2018. Zyra e Kryeministrit Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe të gjitha agjencitë dhe institucionet tjera të përfshira në hartimin dhe implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit do të sigurojnë gjithë mbështetjen e

nevojshme për implementimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit, duke përfshirë edhe përkrahjen e nevojshme financiare. Sekretariati i Këshillit të Sigurisë do të shërbejë si sekretariat për monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

7.4 Kontribuuesit dhe rolet e tyre

Qeveria e Republikës së Kosovës - miraton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit bazuar në propozimin e Grupit Punues Qeveritar si dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar resurset e nevojshme për implementimin e suksesshëm të Strategjisë dhe Planit të veprimit, duke përfshirë edhe koordinimin me donatorët për financimin e aktiviteteve të strategjisë dhe planit të veprimit.

Zyra e Kryeministrit mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin e aktiviteteve lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Zyra e Kryeministrit kryeson Grupin Punues Qeveritar dhe sipas nevojës edhe Grupin/grupet Punuese Teknike të cilat themelohen për Strategjinë dhe Planin e Veprimit. Zyra e Kryeministrit në bashkëveprim me Ministrinë e Financave do të sigurojë që këto mekanizma të përkrahjen e nevojshme për kryerjen e punës së tyre.

Koordinatori Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm – për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm. Koordinatorin nacional do të jetë këshilltari i kryeministrit për siguri, i cili do të ketë rolin kryesor në koordinimin e implementimit të Strategjisë, Zyra e Kryeministrit do të caktoj një koordinator nacional i cili do të kujdeset për koordinimin e implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- ✓ Këshillon Kryeministrin lidhur me ekstremizmin e dhunshëm, radikalizmin dhe luftën kundër terrorizmit dhe çështjet e ndërlidhura të sigurisë nacionale;
- ✓ Udhëheq grupin punues qeveritar për hartimin dhe rishikimin e strategjisë dhe planit të veprimit;
- ✓ Koordinon implementimin e Strategjisë Nacionale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm;
- ✓ Është pikë kontakti dhe koordinimi me donatorët sa i përket implementimit të aktiviteteve të ndërlidhura me implementimin e strategjisë;
- ✓ Bashkëpunon ngushtë dhe koordinon përpjekjet me qeverinë, ministrinë, misionet dhe organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile, bashkësitë fetare, institucionet e sigurisë dhe inteligjencës dhe akterët tjerë relevant;

Grupi Punues Qeveritar -është përgjegjëse për hartimin, rishikimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Grupi do të paraqesë propozimet për miratim Qeverisë së Republikës së Kosovës. Përbërja e grupit punues përcaktohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Përveç përfaqësuesve të Ministrive dhe agjencive relevante të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës, në grupin

punues qeveritar duhet marrin pjesë edhe përfaqësues të Bashkësive fetare, medieve, OJQ-ve, si dhe në cilësinë e vëzhgueseve dhe ekspertëve në grupin punues do të ftohen edhe përfaqësues të mekanizmave ndërkombëtar duke përfshirë Ambasadën e SHBA-së, UNDP-në, OSBE-në, ICITAP, EULEX, Ambasadat tjera sipas interesimit të tyre dhe ekspert tjerë vendor dhe ndërkombëtarë.

- ✓ Grupi Punues Qeveritar duhet të siguroj pjesëmarrjen e institucioneve relevante në hartimin, implementimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Kjo duhet të bëhet duke i ftuar përfaqësuesit e tyre në mbledhjet e Grupit Punues Qeveritar në rast se konsiderohet e nevojshme nga këndvështrimi i çështjes në fjalë.
- ✓ Grupi Punues Qeveritar raporton Qeverisë së Republikës së Kosovës së paku dy (2) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike ose operative për gjetjet në lidhje me zbatimin dhe monitorimin të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- ✓ Grupi Punues Qeveritar do të mbajë së paku dy (2) takime brenda një viti kalendarik. Grupi do të ndihmohet nga Sekretariati. Grupi Punues Qeveritar mund të angazhoj në punën e saj ekspertë të jashtëm sipas nevojës.

Sekretariati i Këshillit të Sigurisë do të shërbejë si sekretariat përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

- ✓ Ai është përgjegjës për të ndihmuar Koordinatorin Nacional dhe Grupin Punues Qeveritar në implementimin e strategjisë dhe planit të veprimit.
- ✓ Ai do të përgatisë gjetjet dhe propozimet me shkrim lidhur me hartimin, rishikimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.
- ✓ Sekretariati do të përdor materialin e mbledhur për Grupin Punues Qeveritar i cili do të vendosë për veprime të mëtejshme.
- ✓ Përfaqësuesit e institucioneve të përfaqësuara në grupin punues Qeveritar duhet të bashkëpunojnë ngushtë me Sekretariatit në monitorimin e implementimit të strategjisë dhe planit të veprimit si dhe në rishikimin e tyre.
- ✓ Sekretariati do të mbajë së paku katër (4) takime brenda një viti kalendarik me përfaqësues të institucioneve të përfshira në grupin punues qeveritar.
- ✓ Sekretariati po ashtu mund të angazhoj në punën e vet ekspertë të jashtëm, kur vlerësohet të jetë e nevojshme.

Grupi/grupet Teknike Punuese- mbështesin Sekretariatit dhe Grupin Punues Qeveritar në hartimin, rishikimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Përgjegjësia e tyre është t'i ofrojë procesit mendime të ekspertëve.

- ✓ Anëtarët e Grupit Teknik Punues duhet të veprojnë si pika të kontaktuese të institucioneve që përfaqësojnë, dhe të jenë në kontakt të rregullt me Sekretariatit dhe anëtarët e Grupit Punues Qeveritar.
- ✓ Ata duhet t'i ofrojnë Sekretariatit informata e nevojshme për monitorim të implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.

- ✓ Mbledhjet e Grupit/eve Teknike Punuese dhe materialet e ngjashme do të organizohen nga Sekretariati i cili do të prezantojë konkluzionet për Grupin Punues Qeveritar.
- ✓ Grupi Punues Teknik do të mbajë takime kur vlerësohet të jetë e nevojshme nga Grupi Punues Qeveritar dhe/ose Sekretariati.
- ✓ Përderisa implementimi i kësaj strategjie është kompleks dhe kërkon veprime të koordinuara, secila nga institucionet pjesëmarrëse mund të krijojnë grupe teknike të brendshme dhe me përfshirjen edhe të institucioneve tjera për fusha specifike që ndërlidhen me aktivitetet e parapara me këtë strategji.

Zyra për Planifikim Strategjik në ZKM – në përputhje me udhëzimin Administrativ për kriteret dhe metodologjinë e Hartimit të Dokumenteve Strategjike është përgjegjëse që të marrë pjesë në çdo fazë të hartimit, monitorimit dhe rishikimit të kësaj strategjie, për të siguruar kualitetin, ndërlidhjen me prioritetet strategjike dhe zbatimin e kërkesave të udhëzimit administrativ për hartimin e dokumenteve strategjike.

Institucionet tjera - Zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit është i bazuar në një partneritet në mes institucioneve të sektorit publik, komunitetit, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtare. Përgjegjësitë e tyre janë të specifikuara në Planin e Veprimit.

7.5 Hartimi, rishikimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe plani i veprimit

Përgjegjësitë për hartimin, rishikimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit janë si më poshtë:

- ✓ Ministrinë dhe institucionet që janë anëtarë të Grupit Punues Qeveritar duhet të vlerësojnë mjedisin e tyre strategjik dhe operativ në lidhje me Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm. Ata duhet të marrin parasysh aktivitetet e homologëve të sektorit publik, komunitetit, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë që ndërlidhen me fushën e përgjegjësisë së tyre.
- ✓ Ministrinë dhe institucionet të cilat janë të përfaqësuara në Grupin Punues Qeveritar duhet të raportojnë përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin Teknik Punues në lidhje me gjetjet e tyre që kanë të bëjnë me Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm në Sekretariat të paktën katër (4) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike apo operative;
- ✓ Sekretariati që udhëhiqet nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë do të analizojë informacionin i cili është siguruar nga organizatat anëtare të Grupit Punues Qeveritar. Rezultatet duhet të merren parasysh gjatë hartimit ose rishikimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit. Sekretariati do të përgatisë propozime me shkrim;
- ✓ Sekretariati do të prezantojë propozimet me shkrim për Grupin Punues Qeveritar që do të merren në konsideratë gjatë hartimit, rishikimit apo përshtatjes së Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit;
- ✓ Grupi Punues Qeveritar me mbështetjen e Sekretariatit do të jetë përgjegjës për hartimin e propozimeve në lidhje me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit;
- ✓ Grupi Punues Qeveritar do të prezantojë propozime që lidhen me hartimin, rishikimin apo përshtatjen e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Qeverisë së Republikës së

Kosovës së paku dy (2) herë brenda një viti kalendarik dhe menjëherë nëse kërkojnë nevojat strategjike ose operative; dhe

- ✓ Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendos për miratimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit e Veprimit bazuar në propozimet e Grupit Punues Qeveritar.

7.6 Zbatimi dhe monitorimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit

Përgjegjësitë që lidhen me zbatimin dhe monitorimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë janë si më poshtë:

- ✓ Institucionet publike të obliguara të cilat do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë janë të përcaktuara në Planin e Veprimit;
- ✓ Autoritetet mbikëqyrëse do të jenë institucione të obliguara në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të institucioneve të sektorit publik dhe sektorit privat ose të tretë të cilat janë nën mbikëqyrjen e tyre;
- ✓ Qeveria e Republikës së Kosovës, ministrinë dhe institucionet publike relevante do të sigurojnë që përgjegjësia për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit janë pjesë integrale e detyrave zyrtare të institucioneve publike të obliguara. Prandaj, objektivat e Strategjisë dhe veprimet e Planit të Veprimit do të integrohen në buxhetet e tyre dhe Planet e Performancës;
- ✓ Institucionet e obliguara do të raportojnë katër (4) herë brenda një viti kalendarik përmes përfaqësuesve të tyre në Grupin/grupet Teknike Punuese në lidhje me rezultatet e zbatimit të planit të veprimit sipas kërkesës së Sekretariatit.
- ✓ Sekretariati do të hartojë katër (4) herë brenda një viti kalendarik, një raport për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit.
- ✓ Sekretariati duhet ti raportoj të paktën dy (2) herë brenda një viti kalendarik për rezultatet e procesit të zbatimit dhe monitorimit Grupit Punues Qeveritar.
- ✓ Grupi Punues Qeveritar do të raportojë dy (2) herë brenda një viti kalendarik rezultatet e procesit të monitorimit të zbatimit për Qeverinë e Republikës së Kosovës duke përdorur raportin e hartuar nga Sekretariati.
- ✓ Qeveria e Republikës së Kosovës do të vendosë lidhur me masat e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit bazuar në raportimin e Grupit Punues Qeveritar.
- ✓ Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e masave të mundshme korrigjuese duhet t'i njoftohen institucioneve të obliguara nga ana e Sekretariatit.
- ✓ Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë përgjegjësi të përgjithshme për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që Shpie në Terrorizëm dhe Planit të Veprimit.